



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:150499

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654017

PKR.nr.259/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes Alban Ajvazi, si dhe pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale të pandehurve: I.H, V.S, H.M, N.K, F.P, V.C, B.V dhe F.H, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.508/20 të datës 27.04.2021, konform dispozitave të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, me datë 03.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.508/20 të datës 27.04.2021.

PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

I. I.H, nga i ati Sh. dhe nëna B., e gjinisë I., i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. V.S, nga i ati N. dhe nëna L., e gjinisë H., i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

III. H.M, nga i ati H. dhe nëna N., e gjinisë O., i lindur më ..., në fshatin ..., me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

IV. N.K, nga i ati M. dhe nëna Z., e gjinisë H., i lindur më ..., në G., Komuna e Podujevës, me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

V. F.P, nga i ati G. dhe nëna A., e gjinisë M., i lindur më ..., në ..., me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

VI. V.C, nga i ati T. dhe nëna Z., e gjinisë K., i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

VII. B.V, nga i ati A. dhe nëna F., e gjinisë S., e lindur më ..., në ..., Komuna Prishtinë, me adresë banimi në ..., në Fushë Kosovë, me nr. personal ..., e gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

VIII. F.H-Vitaku, nga i ati I. dhe nëna M., e gjinisë K., e lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjë PP.I.nr.508/20 të datës 27.04.2021, kundër të pandehurve: I.H, V.S, H.M, N.K, F.P, V.C, B.V dhe F.H.

Gjykata me datën 01.02.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën të pandehurit ishin deklaruar të pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata i ka udhëzuar të njëjtit që brenda afatit prej 30 ditësh të paraqesin: çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Të pandehurit: H.M, N.K, dhe V.C, nuk kanë paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës. Ndërsa të pandehurit: I.H, V.S, F.P, B.V dhe F.H përmes mbrojtësve të tyre, brenda afatit ligjor gjykatës i kanë paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës. Pas kësaj Gjykata me Aktvendimin e saj nën shenjë PKR.nr.259/21 të datës 03.04.2023 i ka refuzuar kërkesat e lartcekur, ku mbrojtja kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor kanë ushtruar ankesë.

Gjykata Apelit me aktvendimin e saj nën shenjë PN.nr.543/23 të datës 25.05.2023 i ka refuzuar si të pa bazuar ankesat e mbrojtjes.

Prokurori i shtetit Bashkim Zeqaj para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me parashtresën e datës 24.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga ndjekja penale, ndaj të pandehurve I.H, V.S, H.M, N.K, F.P, V.C, B.V dhe F.H në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se është krijuar praktika gjyqësore që në raste të njëjta penale aktakuza është refuzuar ose është marr aktgjykim lirues nga gjykata si dhe duke pas parasysh dashjen të pandehurve si element parësor i kryerjes së veprës penale.

Gjykata pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja e penale për të pandehurit, analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitivë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.259/21, datë 03.05.2024

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari
Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.